

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/08/2026

PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – PUNË
(PROCEDURË E HAPUR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM.

I mbajtur sot në datë 03.08.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, person përgjegjës të emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit me Nr. 783/2 Prot datë 03.08.2026 për procedurën e prokurimit e Hapur-Punë me objekt: **“Ndërtimi i linjës 35kV, 1x120mm², Bogë – Theth”**.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Linja të energjisë elektrike 31321100-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 449,681,178.12 (Katërqind e dyzet e nëntë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë lekë e dymbëdhjetë qindarka) Lekë pa TVSH.

Argumentimi: Per realizimin e ketij projekti pasi eshte bere zgjidhja tekniko ekonomike duke analizuar disa variante eshte bere zgjidhja perfundimtare e projektit dhe jane nxjerre materialet dhe pajisjet e nevojshme per kete fuqizim, si dhe volumet e punimeve civile, konstruksione mekanike, elektrike TU etj per te cilat jane perdorur çmimet e sistemit SAP te OSSH, kontrata per punime të ngjashme të realizuara në projektet e fundit dhe cmimet e analizave sipas e-Albania per punimet e parashikuara.

Zhvillimi i kësaj procedure të prokurimit mbështetet në: Nenin 42 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, autoriteti kontraktor zhvillon një procedurë të hapur për kontratë të tipit “me çelësa në dorë”, që përfshin projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin funksional të objektit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8).

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, Dega e Tatim Taksave. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe këstin përkatës për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoritetet përkatëse sipas adresave të regjistruar në QKB. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga ana e tyre gjatë tre viteve të fundit financiare (2023-2024-2025). Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e fondit limit të procedurës së prokurimit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit. *(Kërkesa për*

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si vijon:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht $449,681,178.12 \times 50\% = 224,840,589.06$ lekë (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht $449,681,178.12 \times 2 = 899,362,356.24$ lekë (pa TVSH).

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, (ku të përcaktohet qartë vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer) shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruara në organet tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikatën e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Vertetim leshuar nga subjekti privat, shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruara në organet tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi (2.3.1 – a/b)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat e përcaktuara nga Rr.P.P., konkretisht punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

$449,681,178.12 \times 50\% = 224,840,589.06$ lekë (Dyqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e dyzet mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë lekë e gjashtë qindarka..) pa TVSH.

$449,681,178.12 \times 2 = 899,362,356.24$ lekë (Tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë lekë e njëzet e katër qindarka)- pa TVSH.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE, me qëllim vlerësimin sa më të drejtë dhe objektiv të ofertave të paraqitura.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

a) LIÇENSA PROFESIONALE NE FUSHEN E ZBATIMIT:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **N.P. - 1 A** Punime gërmimi në tokë;
- **N.P. - 2 B** Ndërtime civile dhe industriale;
- **N.P. - 5 B** Punime nëntokësore, ura e vepra arti;
- **N.P. - 11 E** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S. - 8 B** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri;

b) LIÇENSA PROFESIONALE NE FUSHEN E PROJEKTIMIT:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e objektit të kontratës, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe esubjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes ekolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, të ndryshuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 dhe VKM nr. 267, datë 2.5.2024, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR.

d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale

10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

d- Nënstacione elektrike, primare sekondare - linja të tensionit të lartë.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi 2.3.2

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Preventivi është hartuar në mënyrë të tillë, që punime instalimi, civile, bazamentet konstruksionet metalike të linjes re 35kV ajrore, të kete mundësi e zgjidhjes së tij me të mirë teknike në varësi të dimensioneve të shtyllave që do të furnizojë dhe instalojë, por pa ndikuar në pjesën tekniko – ekonomike të projektit.

Konkretisht:

Kategoritë e licensave janë përcaktuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohet të realizohen në funksion të përmbushjes së qëllimit të kontratës, ndërsa klasifikimi i tyre, sipas niveleve

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

(gërmave) përkatëse është është përcaktuar në klasifikimin bazë (A) pasi volumet e punës që do të realizohen janë vetëm sasi / punime të planifikuara në projekt preventivin e kësaj procedure.

- **N.P - 1 A “Punime gërmimi në tokë”**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 1 A** “Punime gërmimi në tokë” konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për gërmime për ndertesen e re të N.Stacionit, kanale kablllo, muret rrethues, etj. konkretisht për punimet si vijon:

➤ **Zërat dhe volumet sipas preventivit.**

Punime gërmimi		
Gërmim dheu për gropë shtyllash T/L, në tokë të fortë kat IV, ~ 2.5 m, sipërfaqe 4 m ²	m ³	1206.77
Gërmim dheu për gropë shtyllash T/L, në tokë të fortë kat IV, ~ 2.5 m, sipërfaqe 4 m ²	m ³	1091.68
Gërmim dheu për gropë shtyllash T/L, në tokë të fortë kat IV, ~ 2.5 m, sipërfaqe 4 m ²	m ³	1206.50

- **N.P. - 2 B Ndërtime civile dhe industriale;**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 2 B** Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për objektin ndertese e re, bazamente të pajisjeve të N.Stacionit, muret rrethues, etj. konkretisht për punimet si vijon:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Ndertime civile dhe industriale		
Shtrese betoni C 12/15	m ³	34.56
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	245.30
Shtrese betoni C 12/15	m ³	31.16
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	217.42
Shtrese betoni C 12/15	m ³	34.63
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	188.54
Shtrese betoni C 12/15	m ³	83.65
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	283.58
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	115.73
Shtrese betoni C 12/15	m ³	15.89
Shtrese betoni C 12/15	m ³	35.54
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	227.72

• **N.P. - 5 B “ Punime nëntokësore, ura e vepra arti ”**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rishikime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma"

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për kanale ekabllove nenetoke, germime per baamentet e transformatoreve te fuqise, etj. konkretisht për punimet si vijon:

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Punime nentokesore		
Prerje asfalti me disk, ne te dy anet.	ml	87.48
Rruge ndihmese	km	8.55
Germim dheu per gropa shtyllash T/L, ne toke te forte kat IV, ~ 2.5 m, sip tabani 4 m ²	m ³	1574.64
Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m ²	26.24
Mbushje ngjeshje dheu të gërmuar në kanal ,tokë e fortë	m ³	915.48

- **N.P. - 11 E “Ndërtim për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike”.**

Kategoria **N.P - 11 E** përfshin “Ndërtim për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike”, ku konsiderohen ndërtim, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme elektrike si ne pajisjet e tensionit te larte, te mesem TU, ne N.Stacion dhe në ndërtesat e tij si vijon:

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike		
F.V. Shtylla metalike te zinguara me bullona	ton	467.50
Punime izolacioni terheqes tek TT + morsete terh. ne shtylla ankerore 35 kV	shtylle	25
Punime izolacioni terheqes dopjo TD + morsete terh. ne shtylla ankerore 35 kV	shtylle	27
Punime izolacioni vares tek VT +morset mbajt. ne shtylla ndermjetese 35 kV	shtylle	2
Punime izolacioni vares dopjo VD +morset mbajt. ne shtylla ndermjet 35 kV	shtylle	53
Shtrirje e terheqje 3 fije teli (percjellesa) me makineri, ACSR me seksion 120/20 mm ²	km	16.95
F.V. denfera ne linjat T/L 110kV ne shtylla ndermjetese	shtylle	50
F.V. denfera ne linjat T/L 110KV ne shtylla ankerore tel terhequr	shtylle	45
F.V. tubo bashkues per percjelles ACSR me seksion 120 mm ²	cope	20
F.V. Shtrirje terheqje Trosi OPGW 63 mm ² 24 fije ,Tipi G652	km	16.95
F.V. morseteri mbajttese per OPGW , ne linja 110 kV	shtylle	105

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

F.V. morseteri terheqesee per OPGW , ne linja 110 kV	shtylle	45
F.V Demfer per OPGW 63 m2	shtylle	95
F.V Joint Box per OPGW	cope	13
Tokezim Trosi per linja T/L 100 kV	shtylle	95
Pergatitje e vendosje tabela sinjalizimi	shtylle	95
F.V. shirit togezimi St/Zn 40x4 mm perfshi matjen e rezistences per shtyllat	ton	5.60
F.V. Elektrode tokezimi profil zingato e bakerizuar L=1.5 m	cope	550
F.V ne toke kabell Al, XLPE, 35kV (1x240/25 Cu) mm ² per lidhjen kabllore 35kV.	ml	3600.00
F.V Shkarkues 35kV ne shtylla TL	cope	6
F.V. Terminale 35kV, 1 fazore, te jashtme (150-400mm ²) per lidhjen e kabllit me percjellsin ACSR ne shtylle ne linjen 35kV	cope	6
F.V. Xhunto 35kV, 1 fazore, (95-240mm ²) per linjen kabllore 35kV	cope	9
F.V. Elektrode tokezimi profil zingato e bakerizuar L=1.5 m	copë	50
F.V. Percjelles Cu 50mm ² zbrites + kontur tokezimi	ml	50.00
F.V. shirit sinjalizimi per kablllo	ml	1100.00
Kenotrimi i kablllove dhe kokave te kabllit	cope	6

- **N.S - 8 B Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri.**

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 8 B** “Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri” përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për punimet si vijon:

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Ndertime parafabrikat me beton te armuar		
Themel betoni C16/20 (betonim tubash kalim rruge)	m ³	15.75
F.V. Shtylla metalike te zinguar me bullona	ton	487.00
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	245.30
F.V. hekur betoni Ø > 10 mm	ton	8.46
F.V. hekur betoni Ø 6 - 10 mm	ton	1.39
Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m ²	62.42
Shtrese betoni C 12/15	m ³	31.16
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	217.42
F.V. hekur betoni Ø > 10 mm	ton	7.30
F.V. hekur betoni Ø 6 - 10 mm	ton	1.17
Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m ²	68.98
Shtrese betoni C 12/15	m ³	34.63

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	188.54
F.V. hekur betoni Ø > 10 mm	ton	7.42
F.V. hekur betoni Ø 6 - 10 mm	ton	0.29
Shtrese betoni C 12/15	m ³	83.65
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25(betonim bazamente shtyllash)	m ³	283.58
F.V. hekur betoni Ø > 10 mm	ton	26.75
F.V. hekur betoni Ø 6 - 10 mm	ton	5.08

Argumentim teknik për kërkesën mbi licencat profesionale në fushën e projektimit.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industrial.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

d- Nënstacione elektrike, primare sekondare - linja të tensionit të lartë.

Në përputhje me natyrën dhe shkallën e vështirësisë teknike të punimeve të këtij objekti prokurimi është kërkuar zgjidhja sipas termit “Turn key” që përfshin rikonstruksionin dhe fuqizimin e N.Stacionit elektrike të Shpërndarjes me zgjidhjet dhe pajisjet me të fundit për keto projekte.

Realizimi i këtij projekti kërkon përfshirjen e stafit projektues në licensat e kompanisë të specializuar në fushën:

- **3. Projektues konstruktor**
- **4. Projektues instalator**
- **10. Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike**

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Konkretisht, kërkohet që dokumentacioni i ofertës të përfshijë licencat për këto kategori projektuesish:

- **3. Projektues konstruktor – d.** Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

Eshte vleresuar kërkesa për licencën drejtues teknik i kategorise licencën "**Projektues konstruktor – d. Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike**" sepse lidhet ngushtesisht me projektimin e strukturave mbajtëse si janë konstruksionet metalike të pajisjeve 110kV, rrufepritesat etj dhe objekteve ndihmëse në nënstacione, duke garantuar siguri dhe stabilitet mekanik sipas normave të ndërtimit.

Për sa me sipër projektuesi konstruktor është i nevojshëm sepse është i domosdoshëm për realizimin e projektimit të linjave të transmetimit (TL), pasi strukturat mbajtëse të këtyre linjave përbëjnë elementin kryesor që garanton sigurinë, qëndrueshmërinë dhe funksionimin e tyre afatgjatë si mëposhte:

- Vlerësimin e kapacitetit mbajtës të themeleve ekzistuese dhe strukturave metalike të shtyllave në linjat e transmetimit të energjisë.
- Verifikimin e ndikimit të ngarkesave statike dhe dinamike, duke përfshirë peshën e përcjellësve, ngarkesat nga era, akulli, tërheqjet mekanike të përcjellësve, si dhe efektet sizmike, në përputhje me Eurokodet dhe standardet IEC të zbatueshme.
- Projektimin e masave të përforcimit të themeleve dhe strukturave metalike, kur kjo është e nevojshme nga analizat statike dhe dinamike.
- Verifikimin e stabilitetit të shtyllave në kushtet më ekstreme të ngarkesës, duke garantuar koeficientët e kërkuar të sigurisë.
- Hartimin e detajeve konstruktive për lidhjet metalike, ankorimet, elementët e përforcimit dhe themelet, duke siguruar jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë strukturor të linjës.

Prania e një Projektuesi Konstruktor me këtë kategori licence garanton që të gjitha strukturat mbajtëse të linjës së transmetimit do të projektohen ose verifikohen në përputhje me kërkesat teknike, standardet kombëtare SSH dhe ato ndërkombëtare IEC/EN, si dhe me normat e sigurisë strukturore, duke minimizuar rrezikun e dështimit mekanik gjatë shfrytëzimit të linjës dhe duke siguruar funksionimin e saj të besueshëm për të gjithë ciklin e jetës së investimit.

- **4. Projektues instalator – c.** Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industrial.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Kërkesa për licencën "**Projektues instalator – c. Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale**" është vlerësuar e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin projektimin e linjave elektrike, dhe ky projektues ekspert zotëron kompetencat profesionale për hartimin e zgjidhjeve teknike që garantojnë funksionimin e sigurt, të besueshëm dhe në përputhje me standardet në fuqi të sistemit elektrik.

Projektuesi Instalator është përgjegjës për:

- Hartimin e projektit të linjës elektrike, duke përcaktuar konfigurimin, parametrat teknikë dhe karakteristikat e elementëve përbërës të saj.
- Përzgjedhjen e përcjellësve, kablllove, izolatorëve, armaturave, aksesoreve dhe pajisjeve elektrike në përputhje me tensionin nominal, kapacitetin transmetues dhe kushtet e funksionimit të linjës.
- Kryerjen e llogaritjeve elektrike për rënien e tensionit, kapacitetet transmetuese të energjisë elektrike, humbjet e saj në linja elektrike, rrymat e lidhjes së shkurtër dhe koordinimin e izolacionit.
- Projektimin e sistemeve të tokëzimit, mbrojtjes nga mbitensionet dhe shkarkimet atmosferike, si dhe masave të mbrojtjes elektrike në përputhje me standardet SSH, IEC, EN dhe rregulloret teknike në fuqi.
- Përcaktimin e mënyrës së instalimit të linjave, kablllove dhe pajisjeve shoqëruese, duke garantuar sigurinë elektrike, besueshmërinë në operim dhe lehtësinë e mirëmbajtjes së tyre.
- Bashkërendimin e projektit elektrik me disiplinat e tjera të projektimit (ndërtimore, konstruktive, mekanike), në mënyrë që zgjidhja përfundimtare të jetë teknikisht e integruar dhe e zbatueshme.

Prania e një Projektuesi Instalator me këtë kategori licence garanton që projekti i linjës elektrike do të hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me kërkesat teknike të operatorit të sistemit, duke siguruar një investim të sigurt, efikas dhe me jetëgjatësi të lartë.

- **10. Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike**
d- Nënstacione elektrike, primare sekondare - linja të tensionit të lartë.

Kërkesa për licencën "**Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike**" d- Nënstacione elektrike, primare sekondare - linja të tensionit të lartë, është vlerësuar e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin projektimin e linjave elektrike të transmetimit të energjisë TL.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Kërkesa për projektues të licencuar për Projektimin e impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – linja të tensionit të lartë, është e domosdoshme për realizimin e projektit, pasi objekti i prokurimit përfshin projektimin e linjave të tensionit të lartë, të cilat përbëjnë pjesë kritike të sistemit elektroenergjetik shqiptar dhe kërkojnë njohuri të specializuara teknike.

Projektuesi është përgjegjës për hartimin e zgjidhjeve teknike që garantojnë sigurinë, besueshmërinë dhe funksionimin afatgjatë të linjave të tensionit të lartë, duke përfshirë:

- Projektimin e linjave ajrore të tensionit të lartë, në përputhje me standardet kombëtare SSH dhe ato ndërkombëtare (IEC, EN, Eurocodes dhe standardet e operatorit të sistemit).
- Përzgjedhjen e parametrave teknikë të linjës, përfshirë përcjellësit, izolatorët, armaturat, kabllot elektrike, tokëzimin, aksesoret dhe elementët e tjerë përbërës.
- Kryerjen e llogaritjeve elektrike dhe mekanike, duke përfshirë kapacitetin transmetues të energjisë, rënien e tensionit, humbjet e energjisë, koordinimin e izolimit, distancat e sigurisë, si dhe ngarkesat nga era, akulli dhe efektet sizmike.
- Projektimin e sistemit të tokëzimit dhe mbrojtjes nga goditjet atmosferike dhe mbitensionet, në mënyrë që të garantohet siguria e personelit operative në N.Stacione, pajisjeve dhe rrjetit.
- Hartimin e dokumentacionit teknik, vizatimeve, specifikimeve teknike, dhe dokumentacionit të nevojshëm për zbatimin e projektit.

Ky ekspert është i domosdoshëm për të garantuar që projekti i linjave të tensionit të lartë të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat teknike të operatorit të sistemit dhe standardet ndërkombëtare të projektimit, duke siguruar një infrastrukturë të sigurt, të besueshme, me jetëgjatësi të lartë dhe të aftë për të përballuar kushtet normale dhe ato të avarisë gjatë gjithë ciklit të saj të shfrytëzimit.

Këto licenca përbëjnë gjithashtu përveçse një **garanci teknike edhe ligjore** që operatori ofertues ka kapacitetin profesional, ekspertizën e nevojshme dhe garanton realizimin e plote të projektimit sipas kërkesave të AK dhe ta zbatojë ato me sukses deri në përfundimin e punimeve, për këtë N.Stacion të rëndësishëm të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes .

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktojë disponuesit e këtyre licencave, nëse nuk janë pjesë e stafit të tij, me qëllim realizimin e kontratës.

Keto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe punimet përkatëse për objektin e prokurimit, këto janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me realizimin e

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët duhet figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

- | | |
|------------------------------|---------|
| • Inxhinier Elektrik | 1 (nje) |
| • Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| • Inxhinier Mekanik | 1 (një) |
| • Inxhinier Topograf/Gjeodet | 1 (një) |

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- ✓ Kontratë pune,
- ✓ Diplomën Universitare,
- ✓ Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dy punësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë staf teknik **inxhinier** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) dhe **punonjës të specializuar/kualifikuar**, si më poshtë :

- | | |
|-----------------|---------|
| • Ing. Elektrik | 2 (dy) |
| • Ing. Mjedisi | 1 (një) |

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Teknik Ndërtimi 1 (nje)
- Montator (Të certifikuar për punime në lartësi) 4 (katër)
- Elektriciste 3 (tre)
- Punetore 10(dhjetë)

Për punonjësit me profesionet si më sipër (**përjashtuar inxhinierët**) , operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
3				
4				
5				

- Për stafin teknik **inxhinier** si më sipër, ofertuesit duhet të paraqesin :
 - ✓ Kontratë pune,
 - ✓ Diplomën Universitare,
 - ✓ Libreze pune dhe CV.
 - ✓ Listpagesat E-Sig të shoqërisë.
- Për **teknikët e ndertimit, dhe elektrikistet**:
 - ✓ Kontratën individuale të punës
 - ✓ Diplomën e shkollës së mesme profesionale përkatëse
 - ✓ Libreze pune.
 - ✓ Listpagesat E-Sig të shoqërisë.
- Për **punonjësit e tjere**:
 - ✓ Kontratën individuale të punës;
 - ✓ Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.3 – a & b.

Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe nevojave për realizimin e punimeve.

Numri i inxhinierëve, specialistëve dhe punonjësve sipas profesioneve perkatese, është kërkuar duke vlerësuar rendesine e vecante që ka projekti, shkallen e vështirësisë për shkak të terrenit të thyer malor alpin, kohezgjatjeve e punimeve, si dhe veprimeve të shpejta dhe të sakta gjatë intersektimeve me linja TM/TU gjatë shtrimit të percjellesitë të ri 35kV, duke kufizuar në minimum nderprerjen e energjisë për konsumatorët që linjat ekzistuese furnizojnë.

Numri i tyre në punimet e ndërtimit të linjes, punimet civile të bazamenteve dhe kosntruksionet metalike të shtyllave, punime montimi etj. është bazuar në zerat dhe volumet e parashikuar në punimet e preventivit, për arsye të meposhtme:

Kërkesa që operatorët ekonomikë të disponojnë staf teknik inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) dhe punonjës të specializuar/kualifikuar është vendosur në funksion të garantimit të realizimit të kontratës sipas kërkesave teknike, standardeve në fuqi dhe rregullave të sigurisë në punë. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin punime ndërtimi linje ere me parametra të tensionit të lartë është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë personel me kualifikimin dhe eksperiencën e nevojshme për secilin proces të zbatimit.

Argumentimi sipas profileve:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- **2 (dy) Inxhinier Elektrik** – janë të domosdoshme për organizimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e punimeve në ndërtimin e linjes re elektrike TL, verifikimin e zbatimit të projektit, pasi natyra e projektit përfshin një sërë aktiviteteve teknike që duhet të zhvillohen njëkohësisht në disa fronte pune, duke garantuar cilësinë, sigurinë dhe respektimin e afateve të grafikut të punimeve.
- **1 (një) Ing. Ndërtimi** – është i domosdoshme për realizimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha punimeve civile të nevojshme për ndërtimin e linjave të Tensionit të Lartë (TL), pasi këto objekte infrastrukturore përfshijnë punime komplekse ndërtimore që lidhen me përgatitjen e terrenit, ndërtimin e themeleve, bazamenteve të shtyllës, instalimin e strukturave mbajtëse të linjës etj.
- **1 (një) Ing. Mjedis** – është i domosdoshëm për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të tensionit të lartë, pasi këto punime zhvillohen në zona të ndryshme gjeografike, me një gjatësi rreth 16km dhe mund të kenë ndikim në mjedis, ekosisteme, tokë, ujëra sipërfaqësore, bimësi dhe komunitetet përreth. Prania e një Inxhinieri Mjedis garanton që punimet të realizohen në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi, kushtet e lejes mjedisore dhe praktikatat më të mira të mbrojtjes së mjedisit.
- **1 (një) Ing. Mekanik** – është i domosdoshëm për realizimin me sukses të punimeve të ndërtimit të linjave të Tensionit të Lartë (TL), pasi këto objekte përfshijnë një sërë aktiviteteve që lidhen me komponentët mekanikë të strukturave mbajtëse, pajisjet e ngritjes dhe montimit, si dhe instalimin e elementëve mekanikë të linjës.
- **1 (një) Ing. Topograf/Gjeodet** – është i domosdoshëm për realizimin korrekt të punimeve për ndërtimin e linjave të Tensionit të Lartë (TL), pasi këto objekte shtrihen në distanca të konsiderueshme dhe kalojnë në terrene të ndryshme, duke kërkuar saktësi të lartë në përcaktimin e gjurmës së linjës, pozicionimin e shtyllave dhe kontrollin gjeometrik të të gjithë elementëve të ndërtimit.
- **1 (një) Teknikë Ndërtimi** – janë të domosdoshëm për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të tensionit të lartë, pasi ky lloj projekti përfshin punime civile dhe montimi që zhvillohen njëkohësisht në disa pika përgjatë gjurmës së linjës. Teknikët e Ndërtimit kanë një rol të rëndësishëm në organizimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e punimeve në terren, duke mbështetur inxhinierët përgjegjës të ndërtimit, gjatë gjithë procesit të zbatimit në shtylla dhe bazamentet e tyre.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- **3 (tre) Elektricitistë** – jane te domosdoshem për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të tensionit të lartë, pasi këto punime përfshijnë një numër të madh aktiviteteve elektrike dhe elektromekanike që duhet të kryhen në mënyrë të sigurt, të koordinuar dhe në përputhje me projektin dhe standardet teknike në fuqi
- **4 (katër) Montatore** – jane te domosdoshem për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të tensionit të lartë, pasi këto punime përfshijnë montimin e strukturave metalike, instalimin e elementëve mbajtës dhe vendosjen e pajisjeve të linjës, të cilat kërkojnë personel me përvojë dhe aftësi praktike në punime në lartësi dhe në montime elektromekanike.
- **10 (dhjete) Punetore** – jane te domosdoshem për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të tensionit të lartë, pasi ky lloj investimi përfshin një volum të konsiderueshëm punimesh civile, transporti, montimi dhe sistemimi në terren, të cilat kërkojnë angazhimin e personelit mbështetës gjatë gjithë fazës së zbatimit të kontratës. Jane te domosdoshem edhe për realizimin me cilësi, siguri dhe brenda afateve të punimeve për ndërtimin e linjave të Tensionit të Lartë (TL), pasi këto punime përfshijnë një sërë aktiviteteve ndihmëse manuale që nuk mund të realizohen nga personeli teknik i specializuar (inxhinierë, teknikë dhe elektricitistë), por kërkojnë staf mbështetës në terren.

Ky staf është proporcional me objektin e kontratës dhe synon të sigurojë që punimet të realizohen në mënyrë të sigurt, cilësore dhe brenda afateve të përcaktuara, duke garantuar disponueshmërinë e punonjesve të nevojshme për kryerjen paralelisht të proceseve të ndryshme të punës në fuqizimin dhe rikonstruksionin e N.Stacionit elektrike.

- c) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- ✓ Kontratën e punës,
- ✓ Dëshminë/certifikatën përkatëse.
- ✓ Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.3 - c.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht :

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë një **Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë**, në përputhje me Ligjin Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe me VKM Nr. 312, datë 05.05.2010, "Për miratimin e Rregullores "Për sigurinë në kantier"", është e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin punime në nënstacione elektrike, të cilat klasifikohen si punime me rrezik të shtuar. Gjatë zbatimit të kontratës do të kryhen punime elektrike, montime elektromekanike, punime ndërtimore, ngritje dhe montim pajisjesh me mjete mekanike, si dhe testime dhe vënie në punë të pajisjeve, procese që shoqërohen me rrezik për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve.

Prania e një personi përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë garanton identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, kontrollin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale, monitorimin e respektimit të procedurave të sigurisë, si dhe koordinimin e masave mbrojtëse gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës. Kjo kërkesë synon të minimizojë rrezikun e aksidenteve në punë, të mbrojë jetën dhe shëndetin e punonjësve dhe të sigurojë zbatimin e punimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky argumentim është proporcional me natyrën e kontratës, dhe është i domosdoshëm për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të Tensionit të Lartë (TL), për shkak të natyrës së veçantë të këtyre punimeve, të cilat konsiderohen ndër aktivitetet me nivel të lartë rreziku në sektorin e ndërtimit dhe energjisë elektrike.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Gjatë ndërtimit të linjave TL zhvillohen njëkohësisht punime në lartësi, punime elektrike, punime mekanike, punime civile, transport dhe ngritje të ngarkesave të rënda, ku respektimi rigoroz i kërkesave të sigurisë është kusht thelbësor për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve.

Përgjegjësi për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë është përgjegjës për:

- Hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjitha fazat e realizimit të projektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat kontraktuale.
- Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve profesionale që lidhen me punimet në linjat TL, si rreziku nga puna në lartësi, tensioni elektrik, rënia e objekteve, përdorimi i makinerive të ngritjes dhe kushtet e vështira atmosferike.
- Kontrollin e zbatimit të procedurave të punës së sigurt, veçanërisht gjatë montimit të shtyllave, ngritjes së strukturave metalike, shtrirjes së përcjellësve dhe punimeve pranë instalimeve elektrike.
- Verifikimin e përdorimit korrekt të pajisjeve mbrojtëse personale (PMP) nga personeli, si helmetat mbrojtëse, rripat e sigurisë për punime në lartësi, veshjet mbrojtëse, pajisjet kundër rënies dhe pajisjet mbrojtëse elektrike.
- Organizimin e trajnimeve dhe udhëzimeve periodike për sigurinë në punë, duke siguruar që të gjithë punonjësit të jenë të informuar mbi rreziqet dhe masat parandaluese.
- Kryerjen e inspektimeve të vazhdueshme në kantier, evidentimin e devijimeve nga kërkesat e sigurisë dhe marrjen e masave korrigjuese për eliminimin e situatave të rrezikshme.
- Kontrollin e dokumentacionit të sigurisë, përfshirë autorizimet e punës, lejet për punime në lartësi, evidencat e trajnimeve, kontrollet e pajisjeve dhe regjistrat e incidenteve.
- Koordinimin me drejtuesit e kantierit dhe ekipet teknike, për të garantuar që të gjitha aktivitetet realizohen pa cenuar sigurinë e punonjësve, publikut dhe infrastrukturës ekzistuese.

Ndërtimi i linjave TL përfshin punime në lartësi të konsiderueshme, përdorim të mjeteve ngritëse, montim të strukturave të rënda metalike, punime pranë instalimeve elektrike dhe ekspozim ndaj kushteve të ndryshme atmosferike. Çdo mangësi në menaxhimin e sigurisë mund të sjellë pasoja të rënda për jetën e punonjësve, dëmtime të pajisjeve dhe vonesa në realizimin e projektit.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për këtë arsye, angazhimi i Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë është i domosdoshëm dhe proporcional me kompleksitetin e punimeve të ndërtimit të linjave TL, duke garantuar parandalimin e aksidenteve, respektimin e kërkesave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë, mbrojtjen e personelit dhe realizimin e projektit në përputhje me standardet teknike dhe afatet kontraktuale.

Për këto arsye, kërkesa për një **Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë** është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është e domosdoshme për garantimin e një mjedisi të sigurt pune dhe është në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

d) Operatorët ekonomikë duhet që nga punonjësit e kërkuar më sipër, minimalisht punonjësit e kualifikuar si:

➤ Ing Elektrik	2 (dy)
➤ Ing Ndertimi	1 (nje)
➤ Ing Mekanik	1 (nje)
➤ Teknik Ndërtimi	1 (nje)
➤ Elektricistë	3 (tre)
➤ Montator (Të certifikuar për punime në lartësi)	4 (katër)
➤ Punetore	3 (tre)

*duhet të jenë të pajisur me **dëshminë përkatëse që vërteton kualifikimin nga OMVK** te autorizuar në përputhje me kërkesat ose standardet ekuivalente sipas Rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike.*

Për këtë operatorët ekonomikë krahas dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.3 (a/b), duhet të paraqesin edhe **dëshminë përkatëse që vërteton kualifikimin OMVK**.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.3 - d.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Numri i punonjesve te kualifikuar me lart eshte i nevojshem gjate gjithë periudhes se kryerjes se punimeve per ndertimin e linjes re elektrike dhe kërkesa për OMVK siguron që operatori ekonomik të angazhojë personel të kualifikuar dhe të verifikuar profesionalisht, duke reduktuar rrezikun e realizimit të punimeve nga persona pa kompetencat e nevojshme dhe duke garantuar cilësinë, sigurinë dhe jetëgjatësinë e veprës.

Në veçanti, për ndërtimin e linjave TL, ku çdo gabim teknik gjatë projektimit, montimit apo zbatimit mund të ndikojë në sigurinë e sistemit elektroenergjetik, stabilitetin mekanik të strukturave dhe sigurinë e jetës së punonjësve, kërkesa për pajisjen e personelit me OMVK është një kriter i arsyeshëm, proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

Pra jane shume procese pune ne te njejten kohe, qe kerkojne grup pune me punonjes te kualifikuar per realizimin e tyre me sukses dhe kohen e duhur.

- e) Operatori ekonomik (ne baze te VKM 312 Dt.05.05.2010 për miratimin e rregullores për sigurinë ne kantier) duhet të vërtetojë që minimalisht 4 nga punonjësit e kërkuar te jenë të trajnuar dhe te pajisur me certifikata te punimeve ne lartësi te lëshuara nga shoqëri te licencuara nga ministria përkatëse, te cilët te rezultojnë ne listë pagesat e shoqërisë te paktën për 3 (tre) muajt e fundit duke marre reference datën e hapjes se tenderit.

Për këta punonjës operatorët ekonomikë krahas dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.3 b), duhet të paraqesin certifikatën përkatëse te punimeve ne lartesi

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- ✓ Kontrata e punës
- ✓ Liste pagesat. E-Sig

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.3 – e

Kërkesa që 4 (katër) punonjës të jenë të trajnuar dhe të pajisur me certifikata për punime në lartësi

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

është e domosdoshme për realizimin e sigurt të punimeve gjatë ndërtimit të linjave të Tensionit të Lartë (TL), duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të këtyre punimeve, të cilat zhvillohen në lartësi të konsiderueshme dhe përfshijnë ekspozim të vazhdueshëm ndaj rrezikut të rënies nga lartësia.

Ndërtimi i linjave TL përfshin aktivitete të tilla si montimi i shtyllave, instalimi i traversave, izolatorëve, aksesoreve mekanikë, shtrirja dhe fiksimi i përcjellësve, si dhe punime mirëmbajtëse apo korrigjuese në strukturat e ngritura. Këto aktivitete kërkojnë që personeli i angazhuar të ketë trajnim specifik, njohuri praktike dhe kompetencë të certifikuar për punë në lartësi, në mënyrë që të zbatohen procedurat e sigurta të punës.

Punonjësit e certifikuar për punime në lartësi do të jenë përgjegjës për:

- Kryerjen e punimeve të montimit dhe instalimit në lartësi, duke përdorur në mënyrë korrekte pajisjet mbrojtëse kundër rënies, si rripat e sigurimit, sistemet e ankorimit, linjat e sigurimit dhe pajisjet personale mbrojtëse.
- Montimin e elementëve të shtyllave TL, përfshirë traversat, zinxhirët e izolatorëve, përcjellesit, fibres optike OPGW morsetat e përcjellesve dhe komponentët e tjerë që kërkojnë ndërhyrje në nivele të larta.
- Realizimin e punimeve gjatë shtrirjes, tërheqjes dhe fiksimit të përcjellesve, ku një pjesë e aktiviteteve kryhen në lartësi dhe kërkojnë staf me aftësi të posaçme teknike dhe sigurie.
- Kontrollin e kushteve të sigurisë para dhe gjatë punimeve në lartësi, duke verifikuar përdorimin e pajisjeve të duhura dhe zbatimin e procedurave të punës së sigurt.
- Ndërhyrjen në raste montimi, rregullimi ose verifikimi të elementëve të linjës, pa cenuar sigurinë e personelit dhe integritetin e strukturave.

Numri prej 4 (katër) punonjësish të trajnuar për punime në lartësi është i arsyeshëm dhe i nevojshëm pasi punimet në linjat TL realizohen nga ekipe pune ku kërkohet prania e disa operatorëve të kualifikuar njëkohësisht, për të siguruar:

- punë të vazhdueshme dhe të koordinuar në disa pika të strukturës;
- asistencë reciproke dhe kontroll të masave të sigurisë gjatë punës në lartësi;
- ndërhyrje të shpejta në rast nevojë;
- respektimin e metodologjisë së montimit dhe kërkesave të sigurisë në punë.

Pajisja e këtyre punonjësve me certifikata të trajnimit për punime në lartësi garanton që personeli disponon njohuritë e nevojshme për menaxhimin e rrezikut nga rënia, përdorimin e pajisjeve të

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

mbrojtjes kolektive dhe personale, procedurat e ngjitjes/zbritjes dhe veprimet emergjente.

Për rrjedhojë, kërkesa që 4 (katër) punonjës të jenë të trajnuar dhe të pajisur me certifikata për punime në lartësi është një kërkesë e arsyeshme, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi garanton sigurinë e jetës dhe shëndetit të punonjësve, uljen e rrezikut të aksidenteve, cilësinë e realizimit të punimeve dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe teknike për ndërtimin e linjave të Tensionit të Lartë.

f) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

➤ Automaknist te mjeteve te renda / manovrator 1 (nje)

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- ✓ Kontratat e punës të vlefshme;
- ✓ Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.
- ✓ Liste pagesat. E-Sig

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi 2.3.3 - f.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimalisht **1 (një) automakinist të mjeteve të rënda/manovrator**, të pajisur me **Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP)** të lëshuar nga **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)**, është e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin transportin, manovrimin, shkarkimin, pozicionimin dhe montimin e pajisjeve të rënda

Kërkesa për angazhimin e **1 (një) Automakinisti të mjeteve të rënda / Manovrator** është e domosdoshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të **linjave të Tensionit të Lartë (TL)**, pasi zbatimi i këtyre veprave infrastrukturore kërkon përdorimin e vazhdueshëm të makinerive të rënda dhe pajisjeve speciale për transport, ngritje, pozicionim dhe montim të elementëve të linjës.

Ndërtimi i linjave TL përfshin punime në terrene të ndryshme, shpesh me akses të vështirë, ku kërkohet përdorimi i mjeteve mekanike për realizimin e punimeve civile dhe elektromekanike, të cilat nuk mund të kryhen në mënyrë të sigurt dhe eficiente vetëm me punë manuale.

Automakinisti / Manovratori do të jetë përgjegjës për:

- Operimin e mjeteve të rënda dhe pajisjeve mekanike të kantierit, të tilla si vinça, eskavatorë, mjete ngritëse dhe pajisje të tjera ndihmëse të nevojshme për realizimin e punimeve.
- Ngritjen, transportin dhe pozicionimin e elementëve të shtyllave TL, përfshirë strukturat metalike, traversat, komponentët e montimit dhe materiale të tjera me peshë të konsiderueshme.
- Asistencën gjatë montimit të shtyllave dhe strukturave mbajtëse, duke garantuar manovrimin e kontrolluar të pajisjeve ngritëse sipas udhëzimeve të personelit teknik.
- Mbështetjen e punimeve civile, përfshirë hapjen e rrugëve të aksesit, përgatitjen e platformave të punës, gërmimet për themelet dhe sistemimin e terrenit ku është e nevojshme.
- Transportin dhe shpërndarjen e materialeve në kantier, veçanërisht në zona të largëta ose me kushte të vështira terreni ku ndërtohen linjat TL.
- Kontrollin e përdorimit të sigurt të makinerive, duke respektuar kapacitetet e lejuara të pajisjeve, procedurat e punës dhe kërkesat e sigurisë në kantier.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Prania e një automakinisti/manovratori të kualifikuar është veçanërisht e rëndësishme për shkak se punimet e linjave TL përfshijnë:

- ngritjen e strukturave metalike me masa të mëdha;
- manipulimin e materialeve në lartësi dhe në terrene të pjerrëta;
- përdorimin e pajisjeve mekanike pranë zonave të punës me rrezik të shtuar;
- nevojën për koordinim të saktë ndërmjet operatorit të makinerive dhe ekipeve të montimit.

Angazhimi i 1 (një) Automakinisti të mjeteve të rënda / Manovrator garanton që pajisjet mekanike të përdoren nga personel i autorizuar dhe kompetent, duke reduktuar rrezikun e dëmtimeve të materialeve, aksidenteve në punë dhe vonesave gjatë realizimit të objektit.

Për rrjedhojë, kërkesa për 1 (një) Automakinist të mjeteve të rënda / Manovrator është e arsyeshme, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve për ndërtimin e linjave të Tensionit të Lartë, duke kontribuar në sigurinë e punimeve, rritjen e eficiencës së zbatimit, garantimin e cilësisë së montimit dhe përfundimin e projektit brenda afateve kontraktuale.

Kryerja e këtyre operacioneve kërkon përdorimin e mjeteve të rënda dhe pajisjeve ngritëse, të cilat duhet të operohen nga personel i kualifikuar dhe i pajisur me **DAP**, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo garanton që manovrimi i mjeteve të kryhet në mënyrë të sigurt, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve, dëmtimit të pajisjeve dhe ndërprerjeve të panevojshme të punës, si dhe duke siguruar mbrojtjen e punonjësve dhe të infrastrukturës elektroenergjetike.

Kërkesa është në përputhje me natyrën e kontratës dhe respekton parimin e proporcionalitetit, pasi parashikon vetëm 1 (një) automakinist të kualifikuar, numër i mjaftueshëm për operimin e mjeteve të rënda gjatë fazave të transportit, manovrimit dhe montimit të pajisjeve në kantier.

Ky argumentim lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi në punimet në nënstacione elektrike përdorimi i mjeteve të rënda për transport dhe montim është një proces i domosdoshëm, dhe drejtimi i tyre duhet të kryhet nga operatorë që zotërojnë Dëshminë e Aftësive Profesionale (DAP) sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

2.3.4 Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë, për periudhën Maj - Korrik 2026. Përjashtim nga kjo bën punonjësi i kualifikuar si (Automakinist), i kërkuar sipas gërmës “g”, i cili përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jetë me kontrate shërbimi, vetëm në rastet kur mjetet/makineritë dispononohen me qera.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë :

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj - Korrik 2026.

Argumentimi 2.3.4

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore si pjesë të përvojës së shoqërisë, përvojë kjo e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit, pasi fakti që shoqëria disponon personel të kualifikuar në vijimësi, tregon aftësi të larta profesionale dhe mundësi të mira për organizimin e punës dhe zbatimin me sukses të kontratave që do të lidhen gjatë zbatimit të MK.

Kriteri sipas pikës 2.3.4, të kapacitetit teknik, ku kërkohet që punonjësit të jenë pjesë e shoqërisë për një periudhë tre mujore, vlerësohet në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe në funksin të përzgjedhjes së OE që zotërojnë aftësinë teknike dhe profesionale për zbatimin e kontratës.

2.3.5 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt me emërtesën e artikullit në të cilën duhet të deklarojnë të dhënat e kërkuara, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania Prodhuese e artikullit të ofruar	Referenca për specifikimet teknike sipas katalogëve të artikullit të ofruar
1.	Shtylla me konstruksion metalik		
2.	Percjelles ACSR 120/20mm ²		
3.	Fiber optike OPGW 50, me 48 fibra optike		
4.	Kabell 35kV percjelles Al, 1x240mm ²		

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

5.	Terminale te jashtme 35kV		
6.	Mufte 35kV		
7.	Shkarkues 35kV		

Argumentimi 2.3.5

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të kësaj skede Autoriteti Kontraktor orienton ofertuesit të evidentojnë produktet e ofruara dhe e lidhur me kërkesat e tjera për kualifikim në vijim, AK garantohet për cilësinë e produkteve të ofruara dhe faktin se oferta teknike është bazuar në produkte reale që plotësojnë specifikimet teknike të kërkuesit.

2.3.6 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin Autorizim të prodhuesit/Distributorit të autorizuar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëeb-site, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, për listën e mallrave të mëposhtëm:

- Shtylla me konstruksion metalik
- Percjelles ACSR 120/20mm²
- Fiber optike OPGW
- Kabell 35kV percjelles Al, 1x240mm²
- Terminale te jashtme 35kV
- Mufte 35kV
- Shkarkues 35kV

Argumentim 2.3.6.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet SSH/IEC/DIN/EN.

Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Pajisjet e mesiperme janë elementë të rëndësishëm të sistemit elektroenergjetik dhe kërkojnë garanci të origjinës, cilësisë, përputhshmërisë teknike dhe mbështetjes së prodhuesit.

- ✓ Garantimi i origjinës dhe cilësisë së pajisjeve dhe materialeve.
 - ✓ Përputhshmëria me kërkesat teknike të projektit.
 - ✓ Sigurimi i asistencës teknike dhe shërbimit pas furnizimit
- **Shtylla me konstruksion metalik** duhet të prodhohen sipas kërkesave të projektimit, klasës së materialit, mbrojtjes kundër korrozionit, te zinkuara HDG dhe ngarkesave mekanike të llogaritura për linjën TL.
 - **Përcjellësve ACSR 120/20 mm²** janë elementë kryesorë të transmetimit të energjisë dhe duhet të plotësojnë kërkesat për përçueshmëri elektrike, rezistencë mekanike, diametër, peshë dhe karakteristika termike.
 - **OPGW (Optical Ground Wire)** fibra optike është një komponent i rëndësishëm që shërben si përcjellës mbrojtës dhe komunikim me fibër optike, ndaj kërkon garantimin e cilësisë së fibrave optike, kapacitetit mekanik dhe përputhshmërisë me aksesoret përkatës.
 - **Kabllo 35 kV Al 1x240 mm², terminalet dhe mufte 35 kV** janë komponentë të izolimit dhe lidhjes së sistemit kabllor, ku cilësia e prodhimit ndikon drejtpërdrejt në shmangien e defekteve elektrike dhe shkarkimeve të pjesshme.
 - **Shkarkuesit 35 kV** kanë rol mbrojtës ndaj mbitensioneve atmosferike dhe manovruese, duke mbrojtur izolimin e pajisjeve të sistemit. Për këtë arsye kërkohet që të jenë produkte të prodhuesve të specializuar dhe të shoqërohen me dokumentacionin përkatës të testimeve.

2.3.7 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për materialet/pajisjet e ofruara sipas listës së mëposhtëme, të vlefshme të lëshuara nga prodhuesi, distributori i autorizuar ose ekuivalente të tjer nga institucione të autorizuar. Këto dokumente duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të ofruara me kërkesat teknike dhe standardet e të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- Shtylla me konstruksion metalik
- Percjelles ACSR 120/20mm²
- Fiber optike OPGW
- Kabell 35kV percjelles Al, 1x240mm²

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Terminale te jashtme 35kV
- Mufte 35kV
- Shkarkues 35kV

Argumentim 2.3.7.

Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues të paraqesë pajisje dhe materiale , të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Duke marre parasysh që e gjithë lista e kerkuar perbehet nga pajisje te vecanta qe perdoren ne linja elektrike TL, kerkohet nga prodhuesi qe te deshmoje se eshte prodhues i certifikuar nga institucione nderkombetare sipas standarteve IEC/EN/SSH dhe pajisjet kane kryer testimet e kerkuara, testet tip ose rutine nga prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Kërkesa që operatorët ekonomikë ofertues të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare për materialet dhe pajisjet e ofruara është e nevojshme për të verifikuar përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatueshme, si dhe me kërkesat funksionale të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin furnizimin dhe instalimin e pajisjeve që do të përdoren në N.Stacione elektrike, të cilat janë pjesë rrjetit elektroenergjetik shqiptarë, është e domosdoshme që pajisjet e ofruara të kenë kaluar testimet përkatëse dhe të provohet se plotësojnë kërkesat e sigurisë, performancës, besueshmërisë dhe jetëgjatësisë.

Dëshmitë e testimeve, të lëshuara nga prodhuesi, distributori i autorizuar ose ekuivalente të tyre nga institucione të autorizuar, shërbejnë si provë objektive se materialet dhe pajisjet janë testuar sipas standardeve teknike përkatëse dhe se rezultatet e tyre janë në përputhje me parametrat e kërkuar. Kjo i mundëson autoritetit kontraktor të verifikojë, në fazën e vlerësimit të ofertave, se produktet e ofruara janë të përshtatshme për përdorim në rrjetin elektroenergjetik dhe se nuk krijojnë rrezik për sigurinë, funksionimin dhe vazhdimësinë e furnizimit me energji elektrike.

Kjo kërkesë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi nuk kufizon burimin e dokumentacionit vetëm tek prodhuesi, por lejon edhe dokumente të lëshuara nga distributori i autorizuar ose ekuivalente të tyre nga institucione të autorizuar duke garantuar njëkohësisht konkurrencën dhe verifikimin objektiv të cilësisë dhe konformitetit të materialeve dhe pajisjeve të ofruara sipas pershkrimeve te meposhtme per cdo pajisje.

✓ Testimet për Shtylla me konstruksion metalik

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Shtyllat me konstruktionet metalike të linjave TL janë elementë mbajtës që përballojnë ngarkesa të konsiderueshme mekanike nga pesha e përcjellësve, ndikimi i erës, akullit dhe kushteve atmosferike.

Testimet dhe kontrollet janë të domosdoshme duhet të garantojnë:

- cilësinë e materialit metalik dhe karakteristikat mekanike të çelikut;
- verifikimin e dimensioneve dhe përputhshmërisë me projektin;
- cilësinë e saldimeve dhe lidhjeve mekanike;
- cilësinë e mbrojtjes kundër korrozionit (galvanizimit);
- aftësinë mbajtëse dhe qëndrueshmërinë mekanike të strukturave.

✓ **Testimeve për përjellesin ACSR 120/20 mm²**

Përcjellesi ACSR është elementi kryesorë i transmetimit të energjisë elektrike dhe duhet të garantojnë parametra elektrike dhe mekanike gjatë gjithë jetëgjatësisë së linjës.

Testimet janë të nevojshme sepse verifikojnë:

- rezistencën elektrike të përcjellesit;
- përbërjen dhe karakteristikat e materialve perberes aluminit dhe çelikut;
- rezistencën mekanike në tërheqje;
- diametrin, peshën dhe karakteristikat fizike;
- përputhshmërinë me parametrat e projektimit të kerkuar.

✓ **Testimet për fibrën optike OPGW.**

Fibra optike OPGW ka funksion të dyfishtë: mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike dhe transmetimin e komunikimeve nëpërmjet fibrës optike.

Testimet janë të nevojshme për të garantuar:

- humbjet optike të fibrave;
- kapacitetin dhe cilësinë e transmetimit të të dhënave;
- rezistencën mekanike ndaj tërheqjes;
- mbrojtjen e fibrave optike gjatë instalimit dhe operimit;
- përputhshmërinë me aksesorët e linjës.

✓ **Testimet për kabllon 35 kV Al 1x240 mm²**

Kabllo të tensionit të mesëm janë komponentë kritikë të izolimit dhe transmetimit të energjisë.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Testimet duhet të konfirmojnë:

- rezistencën e izolimit;
- rezistencën e përcjellësit;
- testet e tensionit të lartë;
- kontrollin e izolimit dhe mbështjellësit;
- verifikimin e mungesës së defekteve që mund të shkaktojnë shpime elektrike ose defekte gjatë operimit.

✓ Testimet për terminalët e jashtë dhe muftë 35 kV

Terminalët dhe muftë janë pika kritike të lidhjes së kabllave, ku gabimet e prodhimit ose instalimit mund të shkaktojnë defekte serioze.

Testimet janë të nevojshme për:

- kontrollin e qëndrueshmërisë dielektrike;
- verifikimin ndaj shkarkimeve të pjesshme (PD);
- testimin e izolimit;
- kontrollin e rezistencës mekanike dhe hermeticitetit;
- garantimin e funksionimit të sigurt në kushte pune reale.

✓ Testimet për shkarkuesit 35 kV

Shkarkuesit nga mbitensionet kanë rol mbrojtës për pajisjet elektrike dhe izolimin e sistemit.

Testimet duhet të garantojnë:

- tensionin maksimal të vazhdueshëm të operimit (U_c);
- rrymën nominale të shkarkimit;
- karakteristikën tension–rrymë;
- aftësinë për përballimin e impulseve atmosferike dhe të manovrimit;
- nivelin e mbrojtjes ndaj mbitensioneve.

2.3.8 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/për listën e materialeve sipas skedës teknike që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike bazë..

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Argumentim 2.3.8

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të paraqesë katalogët ose fragmente të katalogëve të prodhuesit për materialet dhe pajisjet e ofruara është e nevojshme për të mundësuar verifikimin objektiv të karakteristikave teknike të pajisjeve, produkteve dhe përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Katalogët teknikë përbëjnë dokumentacionin zyrtar të prodhuesit, në të cilin pasqyrohen parametrat teknikë, karakteristikat funksionale, dimensionet, performanca, standardet e zbatueshme dhe të dhëna të tjera të nevojshme për vlerësimin e ofertës.

Paraqitja e këtij dokumentacioni i mundëson autoritetit kontraktor të kryejë një verifikim të qartë dhe të paanshëm të përputhshmërisë së pajisjeve të ofruara me kërkesat e specifikimeve teknike, duke shmangur paqartësitë dhe duke siguruar që produktet e propozuara janë të përshtatshme për përdorim në nënstacionet elektrike. Gjithashtu, katalogët teknikë shërbejnë si bazë për identifikimin e modelit të ofruar dhe për verifikimin e parametrave të deklaruar nga ofertuesi.

Kjo kërkesë është në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit, pasi u kërkohet të gjithë operatorëve ekonomikë të paraqesin dokumentacionin teknik zyrtar të prodhuesit për materialet që ofrojnë, duke krijuar kushte të barabarta për vlerësimin teknik të ofertave dhe duke garantuar që pajisjet e përzgjedhura plotësojnë kërkesat funksionale, të cilësisë dhe të sigurisë të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur, ose me kontratë shërbimi për periudhën e kryerjes së punimeve të kontratës, me një program të licencuar “PLS CADD and TOWER” ose ekuivalentet, si dhe një person të certifikuar për përdorimin e këtij programi.

Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesit duhet të paraqesin:

1. deshmi/licence e paisjes me programin e licencuar / kontratën përkatëse të shërbimit
2. çertifikatat e punonjesit të certifikuar
3. listpagesat E-Sig të punonjesve të sipercituar.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi 2.3.9

Kjo kerkese eshte e nevojshme pasi ne kete menyre mund te bëhet llogaritja, projektimi i linjave, analiza e ngarkesave mekanike dhe elektrike të linjave tensionit të lartë.

Gjithashtu ne menyre qe te mos kete kufizim tregu ne ofertim eshte lene mundesia dhe per aplikacione te tjera te ngjashme mjafton qe kopja elektronike e projektit te jete ne formatin “.bak” file ne menyre qe projekti te jete i lexueshem nga softet.

Por eshte e domosdoshme qe nje operatori ekonomik ose personi qe do te hartoje projektin te kete nje licencim ose trajnim personal qe deshmon kapacitet teknike dhe aftesine ne perdorimin e ketij software apo atyre ekuivalente.

Me ane te software PLS CADD ndertohet profili gjatesor, llogariten varjet e percjellesit , si dhe nxirren ngarkesat ne strukturen e shtyllave nga percjellesit dhe ne kushte atmosferike te veshtira si me bore e ndrice, dhe ere.

Ky është një kriter i nevojshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim për të vërtetuar kapacitetet e ofertuesit mbi realizimin me suksese të objektit të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky aplikacion sherben dhe eshte i lidhur ngushtesisht me realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi. Ky aplikacion nuk e kufizon konkurrencen per shkak se mund te blihet lehtesisht nga çdo OE ofertues.

2.3.10 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr.	Pershkrimi i mjetit	Sasia	Gjendja
1.	Kamion transportues vete shkarkues me Vinc mbi 2.5 Ton	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
2.	Kamion me vinc deri ne 20 ton	1(nje) copë	Pronësi ose me qera

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

3.	Eskavator	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
4.	Motoarganello	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
5.	Makineri terheqje percjelles trosi, OPGW ≥ 35 kN	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
6.	Makineri leshuese (frenuese) percjelles tros, OPGW ≥ 35 kN	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
7.	Falkone (pa motoarg.)	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
8.	Set veglash per kablo, (Motoprese Hidraulike) ≥ 35 kN	1(nje) copë	Pronësi ose me qera

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimit të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi 2.3.10.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Mjetet dhe pajisjet si më sipër kërkohen referuar zërave të preventivit të punimeve.

Konkretisht mjetet dhe pajisjet e kërkuara, janë si më poshtë :

Pajisjet e mesiperme janë kërkuar si domosdoshmeri për realizimin e punimeve në rikonstruksionin dhe fuqizimin e këtij N.Stacioni, të cilat u referohen edhe zërave të punimeve që do të kryehen, materiale që do të transportohen si më poshtë:

- **Kamion transportues vete shkarkues me Vinc deri në 5 ton.**

Kërkesa për domosdoshmerinë e 1 (një) kamioni transportues vetëshkarkues me vinç me kapacitet ngritës deri në 5 ton është e domosdoshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të Tensionit të Lartë, pasi ky mjet garanton transportin, ngarkimin, shkarkimin dhe pozicionimin e sigurt të materialeve dhe pajisjeve të rënda që përdoren gjatë ndërtimit të linjës.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Ndërtimi i linjave TL përfshin transportin dhe montimin e komponentëve me peshë të konsiderueshme, si konstruksione metalike, traversa, elementë të shtyllave, barabane të percjelleseve ACSR me gjatësi totale rreth 50km dhe një peshe totale të përafërret rreth 25ton, me , kablo OPGW, kablo 35 kV, terminale, muftë, shkarkues dhe materiale të tjera ndihmëse. Për manipulimin e tyre kërkohet përdorimi i një mjeti të specializuar që kombinon funksionin e transportit me atë të ngritjes.

- **Kamion me vinc deri në 20 ton.**

Kërkesa për disponimin e 1 (një) kamioni me vinç me kapacitet ngritës deri në 20 ton është e domosdoshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të Tensionit të Lartë, pasi këto punime përfshijnë transportin, ngritjen dhe montimin e elementëve me përmasa dhe peshë të konsiderueshme, të cilët nuk mund të manovrohen me mjete me kapacitet më të vogël.

- **Eskavator** – për gërmime dhe hapje kanalesh në zona ku kërkohet lëvizje e shpejtë brenda ose midis zonave të kantierit.
- **Depozitë uji 5000 L** – për furnizim me ujë për betonime, pastrim dhe nevoja teknike të kantierit.
- **Motoarganello**

Kërkesa për disponimin e motoarganellos është e domosdoshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të shtyllave të linjave të Tensionit të Lartë, pasi kjo pajisje është një mjet mekanik i specializuar që përdoret për tërheqjen, ngritjen, tendosjen dhe pozicionimin e elementëve të strukturave, duke garantuar siguri, saktësi dhe efikasitet gjatë montimit.

- **Makineri tërheqje percjelles trosi, OPGW ≥ 35 kN**

Kërkesa për disponimin e makinerisë për tërheqjen e përcjellësve dhe fibres optike OPGW me forcë tërheqëse ≥ 35 kN është e domosdoshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të Tensionit të Lartë, pasi kjo pajisje përbën një nga mjetet kryesore të specializuara për instalimin e përcjellësve dhe kablove në mënyrë të sigurt, të kontrolluar dhe në përputhje me parametrat e projektimit.

Pas përfundimit të montimit të shtyllave dhe strukturave mbajtëse, faza më kritike e ndërtimit të linjës është shtrirja dhe tendosja e përcjellësve ACSR dhe e fibres optike OPGW, proces i cili nuk mund të realizohet në mënyrë profesionale pa përdorimin e makinerive të specializuara të tërheqjes.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- **Makineri lëshuese (frenuese) percjelles tros, OPGW $\geq 35\text{kN}$**

Kërkesa për disponimin e makinerisë lëshuese (frenuese) për përçues dhe fibres optike OPGW me kapacitet frenues $\geq 35 \text{ kN}$ është e domosdoshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të Tensionit të Lartë (TL), pasi kjo pajisje është pjesë integrale e procesit të instalimit të përçuesve dhe kabllave mbrojtëse, duke punuar në mënyrë të sinkronizuar me makinerinë tërheqëse për të garantuar shtrirjen e kontrolluar dhe të sigurt të përçuesve.

Gjatë fazës së instalimit të përçuesve ACSR, trosit mbrojtës dhe kabllot OPGW, nuk mjafton vetëm përdorimi i makinerisë tërheqëse. Për të siguruar një proces të kontrolluar dhe pa dëmtime, është e domosdoshme përdorimi i makinerisë lëshuese (frenuese), e cila kontrollon shpejtësinë e lëshimit të percjellësve dhe ruan tensionin e nevojshëm gjatë gjithë procesit të shtrirjes.

- **Falkone (pa motoarganello).**

Kërkesa për disponimin e makinerisë falkon (pa motoarganello) është e domosdoshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të Tensionit të Lartë, pasi kjo pajisje shërben si një element ndihmës thelbësor gjatë fazës së shtrirjes, drejtimit dhe mbështetjes së përçuesve dhe fibres optikes OPGW ndërmjet shtyllave.

Falkoni përdoret në kombinim me makineritë tërheqëse dhe frenuese, duke mundësuar kalimin e sigurt të përçuesve përgjatë gjurmës së linjës dhe duke garantuar që procesi i instalimit të zhvillohet sipas parametrave teknikë të projektimit.

- **Set veglash për kabllot, (motoprese hidraulike) $\geq 35\text{kN}$.**

Kërkesa për disponimin e setit të veglave për kabllot (motopresë hidraulike) me kapacitet $\geq 35 \text{ kN}$ është e domosdoshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të linjave të Tensionit të Lartë, pasi kjo pajisje përdoret për kryerjen e lidhjeve mekanike dhe elektrike të përçuesve dhe kabllave, duke garantuar cilësi, siguri dhe përputhshmëri me kërkesat teknike të prodhuesit dhe standardet ndërkombëtare.

Gjatë ndërtimit të linjave TL, motopresa hidraulike përdoret për realizimin e presimeve të kontrolluara në komponentë të ndryshëm të linjës, ku kërkohet aplikimi i një force të lartë dhe uniforme për të siguruar lidhje të qëndrueshme mekanike dhe elektrike.

Jane kusht i domosdoshëm për realizimin e të gjitha punimeve si ndërtimore, konstruksioneve metalike, transportimin e materialeve dhe pajisjeve të N.Stacionit por edhe për realizimin e punimeve sipas zerave në preventivin e këtij projekti dhe grafikut të realizimit të punimeve të përcaktuar për këto objekt makinerite dhe mjetet e punës të kërkuara.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

2.3.11 Operoret ekonomik ofertues qe do te realizojnë këtë kontrate, duhet te jene te pajisur dhe të paraqesin certifikatat përkatëse te vlefshme ose ekuivalentet e tyre, te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, SSH EN ISO si me poshtë:

- ✓ Certifikatë **SSH EN ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- ✓ Certifikatë **SSH EN ISO 45001:2023** ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- ✓ Certifikatë **SSH EN ISO 14001:2026** ose ekuivalente mbi “Sistemin e menaxhimit te mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi 2.3.11.

Argumentimi për secilën certifikatë:

1. SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.

Kjo certifikatë kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik disponon një sistem të menaxhimit të cilësisë, i cili siguron planifikimin, kontrollin dhe monitorimin e proceseve të projektimit, furnizimit, instalimit, testimit dhe vënies në punë të pajisjeve. Zbatimi i këtij standardi kontribuon në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që përmbushin vazhdimisht kërkesat teknike dhe kontraktuale, duke minimizuar rrezikun e cilesise se pajisjeve te ofruara per realizimin e kontratës.

2. SSH EN ISO 45001:2023 ose ekuivalente – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Kjo certifikatë është e nevojshme pasi punimet do të kryhen në nënstacione elektrike, ku ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme nga energjia elektrike, pajisjet nën tension, punimet në lartësi, ngritja e pajisjeve të rënda dhe përdorimi i makinerive. Standardi garanton që operatori ekonomik ka implementuar procedura për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve, duke mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punonjësve dhe të personave të tretë gjatë realizimit të kontratës.

3. **Certifikatë SSH EN ISO 14001:2015 ose ekuivalente mbi “Sistemin e menaxhimit të mjedisit”**, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim, vlen edhe versioni i fundit SSH/EN/ ISO 14001-2026.

Kjo certifikatë është e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin punime të linjes kabllore 35kV nga N.Stacioni Kinostudio në styllen e parë ajore afër zones së Linzes në Tiranë, dhe qëllimi është për të siguruar që projekti minimizon dëmet ndaj natyrës dhe përmbush detyrimet ligjore të objektit.

2.3.12 Operatores ekonomik ofertues duhet të plotësojnë skedën teknike të pajisjeve sipas të dhënave të ofertuara.

Argumentim. 2.3.12.

Kjo kërkesë është vendosur në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë, si dhe me dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, pasi i shërben verifikimit të aftësisë së operatorëve ekonomikë për të ofruar pajisje që përmbushin plotësisht kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e interesit publik dhe përdorimin efektiv të fondeve publike.

Kërkesa që operatorët ekonomikë ofertues të plotësojnë Skedën Teknike të detajuar në piken 2.3.5 të pajisjeve sipas të dhënave teknike të ofertuara është vendosur për t'i mundësuar Autoritetit Kontraktor verifikimin e plotë të përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike të objektit të prokurimit, si dhe për të garantuar një proces vlerësimi transparent, objektiv dhe të bazuar në kritere të matshme.

Plotësimi i Skedës Teknike nga vetë operatori ekonomik përbën një deklarament zyrtar të karakteristikave teknike të pajisjeve që ofrohen dhe shërben si bazë për vlerësimin e ofertës teknike. Nëpërmjet saj evidentohen në mënyrë të qartë dhe të unifikuar të gjithë parametrat teknikë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, karakteristikat funksionale, parametrat elektrikë dhe mekanikë, standardet e zbatueshme, certifikimet,

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

performancën, prodhuesin, modelin, vendin e origjinës dhe çdo informacion tjetër të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

Kjo kërkesë siguron që çdo ofertë të paraqitet në një format të standardizuar, duke mundësuar krahasimin objektiv të ofertave mbi të njëjtat elemente teknike dhe duke shmangur interpretimet subjektive apo paqartësitë që mund të lindin nga paraqitja e dokumentacionit teknik në forma të ndryshme. Njëkohësisht, ajo lehtëson procesin e verifikimit të katalogëve teknikë, broshurave, certifikatave të konformitetit, raporteve të testimeve dhe dokumentacionit tjetër mbështetës të paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Për më tepër, Skeda Teknike përbën një dokument referues gjatë fazës së zbatimit të kontratës, pasi karakteristikat teknike të deklaruara nga operatori ekonomik do të shërbejnë si bazë për verifikimin e pajisjeve që do të furnizohen, kontrollin e pranimi, kryerjen e testeve dhe kolaudimin e objektit të kontratës. Në këtë mënyrë, reduktohet rreziku i furnizimit me pajisje që nuk përmbushin kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe garantohet realizimi i kontratës në përputhje me parametrat teknike të ofertuar.

Argumentimi i specifikime teknike:

Në dokumentacionin Teknik për realizimin e këtij projekti janë bashkëlidhur dokumentet me emërtimin “Relacioni Teknik **Ndërtimi i linjes 35kV, 1 x 120mm², Bogë – Theth**” nga Kapitullin 10, fq. 44, deri në fund janë paraqitur specifikimet teknike të detajuara për projektin dhe për mallrat pjesë e kësaj procedure sipas skedes teknike dhe në dokumentin tjetër bashkëlidhur po kësaj procedure me emërtimin “Skeda Teknike **Ndërtimi i linjes 35kV, 1 x 120mm², Bogë – Theth**” janë paraqitur specifikimet teknike për mallrat e kërkuar si dhe kollona për tu plotësuar nga Operatorët Ekonomik me mallrat e ofertuara.

Specifikimet teknike për ndërtimin e linjave të tensionit të lartë janë hartuar për të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të detajuar karakteristikat teknike, funksionale dhe cilësore të punimeve, materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë realizimit të objektit të prokurimit. Këto specifikime janë të domosdoshme për të garantuar që investimi të realizohet në përputhje me standardet kombëtare SSH dhe ato ndërkombëtare IEC, në mënyrë që të realizohet një projekt të sigurt, të besueshëm dhe me jetëgjatësi të lartë.

Specifikimet teknike janë të nevojshme për arsyet e mëposhtme:

- **Garantojnë cilësinë e punimeve dhe materialeve.** Përcaktimi i karakteristikave teknike për shtyllat, përcjellësit, kabllot mbrojtëse, izolatorët, armaturat, aksesoret, sistemet e

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

tokëzimit dhe elementët e tjerë të linjës siguron që të gjitha materialet të jenë të përshtatshme për kushtet e projektimit dhe të funksionimit.

- **Sigurojnë përputhshmërinë me standardet shqiptare dhe ndërkombëtare.** Specifikimet teknike bazohen në standardet SSH, IEC, EN, ISO, Eurocode duke garantuar që linja të projektohet dhe ndërtohet sipas praktikave më të mira ndërkombëtare për keto punime.
- **Garantojnë sigurinë elektrike dhe mekanike.** Përcaktimi i kërkesave për koordinimin e izolimit, distancat minimale të sigurisë, rezistencën mekanike të strukturave, sistemin e tokëzimit dhe mbrojtjen nga goditjet atmosferike minimizon rrezikun e avarive, defekteve dhe aksidenteve gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të linjës.
- **Garantojnë zbatimin korrekt të projektit.** Specifikimet teknike shërbejnë si dokument bazë për projektuesit, mbikëqyrësit dhe zbatuesit e punimeve, duke siguruar që të gjitha fazat e ndërtimit të realizohen sipas projektit të miratuar dhe praktikave të mira inxhinierike.

Për sa më sipër, hartimi i specifikimeve teknike është një element thelbësor për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, pasi garanton cilësinë, sigurinë, besueshmërinë dhe jetëgjatësinë e linjës së tensionit të lartë, si dhe siguron përdorimin efikas të fondeve publike dhe mbrojtjen e interesit publik.

Realizimi i këtij projekti do të jetë **18 muaj nga data e dorezimit të sheshit të ndërtimit** dhe do të jetë sipas termiit **“çelësa në dorë”** për arsyet e mëposhtme:

Përfitimet e realizimit të projektit sipas modelit "Çelësa në Dorë" (Turnkey Project).

Realizimi i objektit me sistemin **"Çelësa në Dorë" (Turnkey)** është zgjidhja më e përshtatshme për ndërtimin e linjës së Tensionit të Lartë (TL), pasi garanton që operatori ekonomik të marrë përsipër të gjitha fazat e projektit, nga projektimi i detajuar, furnizimi i materialeve dhe pajisjeve, ndërtimi, montimi, testimet, komisionimi dhe dorëzimi i objektit plotësisht funksional.

Ky model kontraktual paraqet përparësi të rëndësishme teknike, ekonomike dhe organizative, si më poshtë:

Përfitimet kryesore janë si më poshtë:

1. Përgjegjësi e vetme kontraktuale.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në një kontratë "Çelësa në Dorë", një operator ekonomik mban përgjegjësi të plotë për projektimin, furnizimin, ndërtimin, testimet dhe vënien në punë të linjës TL. Kjo eliminon ndarjen e përgjegjësi ndërmjet disa kontraktorëve dhe shmang mosmarrëveshjet në rast defektesh ose vonesash.

2. Përputhshmëri teknike e të gjithë komponentëve të linjes.

Linja TL përbëhet nga komponentë që duhet të funksionojnë si një sistem unik, si:

- shtylla me konstruksionet metalike;
- përcjellësve ACSR;
- kabllloja OPGW;
- kabllot 35 kV;
- terminalët;
- muftë;
- shkarkuesit;
- aksesoret mekanikë dhe elektrikë.

Kur të gjitha furnizohen dhe instalohen nga i njëjti kontraktor, garantohet përputhshmëria teknike dhe funksionale e të gjithë sistemit.

3. **Koordinim më i mirë i punimeve.**
4. **Reduktimi i afateve të realizimit.**
5. **Kontroll më i mirë i cilësisë dhe punimeve.**
6. **Testim dhe komisionim i integruar.**
7. **Menaxhim më efikas në rast të riskut.**

Ky model garanton një përgjegjësi të vetme për të gjithë objektin, përputhshmëri të plotë teknike të të gjithë komponentëve, kontroll më të lartë të cilësisë, reduktim të risqeve teknike dhe kontraktuale, optimizim të afateve të realizimit dhe ofrimin e një infrastrukture të sigurt, të besueshme dhe me jetëgjatësi të lartë operative. Për këto arsye, kërkesa që objekti të realizohet me sistemin "Çelësa në Dorë" është menduar i justifikuar, proporcionale me natyrën e investimit dhe në interes të garantimit të realizimit me sukses të projektit.

Afati i realizimit të kontratës prej **18 (tetëmbëdhjetë) muaj**, nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin dhe shtrirjen e punimeve që përfshin objekti i kontratës. Projekti përfshin hartimin e projektit të zbatimit, furnizimin e pajisjeve, prodhimin dhe testimin e tyre në fabrikë, transportin, kryerjen e punimeve

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

civile dhe elektromekanike, instalimin, integrimin me sistemet ekzistuese, testimet në terren, vënien në punë, provat funksionale dhe dorëzimin përfundimtar të objektit.

Kontrata do të realizohet sipas termit "**çelësa në dorë**" (**Turnkey**), pasi qëllimi i autoritetit kontraktor është të sigurojë një zgjidhje të plotë dhe funksionale, ku operatori ekonomik mban përgjegjësi të plotë për projektimin, furnizimin, ndërtimin, instalimin, testimin, vënien në punë dhe dorëzimin e objektit në gjendje plotësisht operative. Ky model kontraktimi garanton koordinimin e të gjitha fazave të projektit nga një subjekt i vetëm, shmang problematikat që mund të lindin nga ndarja e përgjegjësisë ndërmjet operatorëve të ndryshëm dhe siguron përputhshmërinë e plotë ndërmjet projektimit dhe zbatimit.

Përcaktimi i afatit prej **18 muaj** është proporcional me kohën e nevojshme për:

- hartimin dhe miratimin e dokumentacionit të projektimit;
- prodhimin dhe furnizimin e pajisjeve, të cilat kanë afate të konsiderueshme prodhimi;
- kryerjen e testeve në fabrikë (Factory Acceptance Tests – FAT) dhe testeve në vendin e instalimit (Site Acceptance Tests – SAT), sipas specifikimeve teknike;
- realizimin e punimeve civile, elektrike dhe elektromekanike;
- integrimin e pajisjeve me sistemet ekzistuese të nënstacionit, përfshirë sistemet e mbrojtjes, automatizimit dhe SCADA, kur është e aplikueshme;
- kryerjen e provave funksionale, vënien në punë dhe dorëzimin e objektit në funksionim normal.

Për rrjedhojë, afati prej **18 (tetëmbëdhjetë) muaj** dhe realizimi i kontratës sipas termit "**çelësa në dorë**" janë në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e projektit, garantojnë koordinimin efektiv të të gjitha fazave të zbatimit, reduktojnë rreziqet teknike dhe organizative dhe sigurojnë dorëzimin e një objekti plotësisht funksional, në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet në fuqi.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatëse vërtetuese për disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te futesit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO ose cdo ekuivalent tjetër.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Reflektim: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Shenim: Kudo që është përdorur fjala “importi” zëvendësohet “importi ose ekuivalent”

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të tjerat duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe;

Garancia e punimeve, në vlerën prej 5% të preventivit, do të rikthehet operatorit ekonomik fitues 2 vite pas kollaudit të punimeve.

Dokumentat e leshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vertetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hages për Vullen Apostile, të datës 05.10.1961;

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njësimin e dokumenteve.

- **Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

Njësia e Prokurimit bëri llogaritjen e afateve dhe vendosi që duke filluar nga data e hedhjes në sistem data e fundit e pranimi të ofertave dhe e zhvillimit të prokurimit të jetë data 19.08.2026 ora 11.00

Personi i autorizuar për të ngarkuar në sistem DST dhe gjithë dokumentat e tenderit do të jetë Z. Aleksandër Pjetri.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

❖ Njesia e Prokurimit

- Aleksandër Pjetri Përgjegjës prokurimi